

VENDIM
Nr. 1415, datë 13.10.2025

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË,
Z. SHKURT NDUE LASKU, KANDIDAT I LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË
SOCIALDEMOKRATE, QARKU SHKODËR, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË
DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 2, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 2409/1 prot., datë 15.9.2025, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të dorëheqjes së deputetit zj. Sabina Mark Jorgo, e zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, propozuar nga “Partia Socialdemokrate”.

Partia Socialdemokrate, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 177, datë 25.2.2025.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 34, datë 28.8.2025, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 11.5.2025.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 1340, datë 27.6.2025, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.

Sipas këtij vendimi, Partia Socialdemokrate, për zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 11 maj 2025, ka fituar 2 (dy) mandate.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit 1340, datë 27.6.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 2 (dy) në listën me parapëlqim, z. Shkurt Ndue Lasku.

Me shkresën nr. 6348 prot., datë 7.10.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për deputet, të Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, z. Shkurt Ndue Lasku, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Shkurt Ndue Lasku, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 24091 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit në

rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për z. Shkurt Ndue Lasku, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Shkurt Ndue Lasku.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Shkurt Ndue Lasku, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Shkurt Ndue Lasku, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit znj. Sabina Mark Jorgo, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër i renditur me numër rendor 2 (dy) në listën me parapëlqim, z. Shkurt Ndue Lasku.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 2, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, z. Shkurt Ndue Lasku.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi